

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME  
PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK

KREU I  
EMRI I SHOQËRISË SELLA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

RENI I  
EMRI I SHOQËRISË

LI Solaris Times mb date 05.09.2019, ong i bashkimit

Identifikimi me nr. MFI12138A  
Shprehja e kësaj shprehje me përgjigje të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK  
(/shprehje e kësaj shprehje me përgjigje të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK)

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË  
KUFIZUAR  
"AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK**

1.1. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK  
1.2. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK  
1.3. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK  
1.4. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK  
1.5. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK

RENI 2  
KOHËZGJATJA

1.6. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK  
1.7. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK  
1.8. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK  
1.9. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK  
1.10. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK

RENI 3  
OBJEKTI I SHOQËRISË

1.11. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK  
1.12. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK  
1.13. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK  
1.14. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK  
1.15. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK

1.16. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK  
1.17. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK  
1.18. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK  
1.19. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK  
1.20. Niveli i Shoqërisë mbledhet në datën e emrimit të kësaj shprehje me emrin "AMELIA SOLAR (ASR)" SHPK

# AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “AMELIA SOLAR (ASR)” SHPK

## KREU I EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

### NENI 1 EMRI I SHOQËRISË

1.1 Sot, ne Tiranë më date 05.09.2019, une i nenshkruari:

Z.Lulzim Kapllanaj, person fizike, shtetas shqiptar, lindur me 15/11/1984, mbajtes i kartes se identitetit me nr. I41115138A

themeloj këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “AMELIA SOLAR (ASR)” SHPK (Me poshte e quajtur “Shoqeria”)

### NENI 2 SELIA

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresen: Autostrada Tirane-Durres, Km 3, pas Universitetit Kristal, Rr. Themistokli Germenji, Tiranë.

2.2 Ortakët mund të vendosin mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Personat përgjegjes për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

### NENI 3 KOHËZGJATJA

3.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### NENI 4 OBJEKTI I SHOQËRISË

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtroje në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:

Veprimtari ekonomiko-juridike në fushën e energjitikës, duke përcaktuar, por pa kufizuar veprimet e papërmëndura: krijimi i sistemeve elektroenergjitike, prodhim, import-eksport të energjisë elektrike me të gjitha format që njeh teknologjia, duke përmendur Panelet diellore, Mullinje e erës, ndërtimin e Hidrocentraleve, mbi burimet hidrike të lejuara nga organet



kompetente. Shit-blerjen e energjisë elektrike tek operatorët lokal apo ndërkombëtar, sipas legjislacionit dhe lejeve të organeve kompetente.

Shoqëria gjithashtu mund të realizojë bashkëpunime me shoqëri të tjera që kanë të njëjtin objektiv ose të ngjashëm me atë të shoqërisë, si dhe në raste të vecanta në sektorë të tjerë, bashkëpunime me persona fizikë, vetëm nëse keto veprime janë të quajtura të nevojshme ose të duhura për realizimin e objektivit të shoqërisë nga organi administrativ.

4.2 Për më tepër shoqëria mund të veproje si agjent/ndermjetes për kryerjen e aktiviteteve të mësipërme dhe bazuar në diskrecionin e saj të vetëm mund të kontraktoje palë të treta për kryerjen e një pjese apo të të gjitha shërbimeve të mesipërme.

4.3 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj përfshirë edhe aktivitetin e ofrimit të shërbimeve, tregtimin, importimin dhe eksportimin e mallrave etj.

4.4 Për të arritur objektin e saj, Shoqëria mund të realizojë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shiptare apo të huaja, si edhe të hyje në marrëdhënie kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, privatë ose publike, vendas ose të huaj.

## **KREU II KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE**

### **NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË**

5.1 Kapitali i Shoqërisë është 2,000,000 Leke, i përbërë nga 1 (një) kuotë, e ndarë si më poshtë:

Lulzim Kapllanaj, person fizik, zotëruar i 1 (një) kuote me 100% (njëqindpërqind) dhe vlerë 2,000,000 Leke.

Derdhja e kapitalit do të kryhet pas regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar, gjatë fazës së zhvillimit të aktivitetit të Shoqërisë.

### **NENI 6 TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETËT**

6.1 Transferimi i kuotave të kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me shitje, trashëgimi, ose me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji.

6.2 Në rast transferimi të kuotave tek persona të tretë jashtë Shoqërisë, qoftë me shitje qoftë me dhurim, ortakut që synon të transferojë kuotat duhet t'i komunikojë ortakëve të tjerë vullnetin e tij me shkrim. Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes të kuotave të ortakëve, me kushte të barabarta, dhe duhet ta ushtrojnë këtë të drejtë brenda 30 ditëve nga marrja e komunikimit të vullnetit të ortakut për të transferuar kuotat.

6.3 Vlera e kuotës që transferohet do të përcaktohet nga një ekspert i emëruar nga ortakët me marrëveshje ose nga gjykata në rast se ortakët nuk bien dakort.

**NENI 7**  
**BARRA MBI KUOTAT E KAPITALIT**

7.1 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rëndohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale

**KREU III**  
**ORTAKËT E SHOQËRISË, FINANCIMET**

**NENI 8**  
**ORTAKËT**

8.1 Ortaku i vetemi shoqërise është:

Z.Lulzim Kapllanaj, i datëlindjes 15.11.1984, lindur ne Fratar, Fier dhe banues në Tiranë, i identifikuar me letërnjoftim nr. I41115138A,

**NENI 9**  
**ORGANET E SHOQËRISË**

9.1 Organet e Shoqërise jane:

- a) Asambleja e Përgjithshme;
- b) Administratoret.

**Neni 10**  
**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

10.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërise dhe merr vendime kur është mbledhur rregullisht.

10.2 Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, në përputhje me ligjin dhe me këtë Statut janë të detyrueshme për të gjithë ortakët përfshirë ata që mungojnë.

10.3 Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e parashikuara nga ky Statut, nga ligji për shoqëritë tregtare, ligje të tjera, dhe sa herë është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë.

10.4 Asambleja e Përgjithshme mbahet ne selinë e Shoqërisë ose në çdo vënd tjetër të shënuar në njoftimin për mbledhje. Njoftimi për mbledhje i dërgohet me shkrim të gjithë ortakëve jo më

vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

10.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratorët. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme mund të kërkohet edhe nga ortakë ose ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme.

10.6 Asambleja e Përgjithshme thirret në sesione të zakonshme e jashtezakonshme.

### **Neni 11 ASAMBLEJA E ZAKONSHME**

11.1 Asambleja e zakonshme mbledhet, çdo vit brenda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vitit financiar, për miratimin e raportit të administratorëve, inventarëve dhe llogarive vjetore.

11.2 Vendimet merren më shumicë të zakonshme të votave në prani të ortakëve me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50 % të kuotave.

11.3 Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikës 11.2, Asambleja do të mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite. Në rast se as në mbledhjen e dytë nuk arrihet kuorumi, ortakët e pranishëm ose rregullisht të përfaqësuar do të përbëjnë kuorumin.

### **Neni 12 ASAMBLEJA E JASHTËZAKONSHME**

12.1 Asambleja e Përgjithshme thirret në sesione të jashtezakonshme sa herë është e nevojshme për marrjen e vendimeve në interes të Shoqërisë.

12.2 Vendimet që kanë të bëjnë me (por pa u kufizuar vetëm në to): ndryshimin e neneve të Statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit, ndryshimin thelbësor të objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, prishjen e Shoqërisë konsiderohen vendime të jashtezakonshme.

12.3 Vendimet e jashtezakonshme merren nga Asambleja e Përgjithshme me  $\frac{3}{4}$  e votave në prani të ortakëve që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave.

12.4 Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikës 12.3, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite. Në rast se në mbledhjen e dytë nuk arrihet kuorumi, ortakët e pranishëm ose rregullisht të përfaqësuar do të përbëjnë kuorumin.



### **Neni 13**

## **PJESËMARRJA, VOTIMI DHE PËRFAQËSIMI**

13.1 Secili ortak ka të drejtën e pjesemarrjes dhe votimit në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Votat e disponuara nga secili ortak janë në numër të barabartë me kuotat e zotëruara prej tij.

13.2 Secili ortak mund të përfaqësohet në mbledhjet e Asamblesë nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë me autorizim. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

### **Neni 14**

## **KOMPETENCAT E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME**

14.1 Asambleja e Përgjithshme vendos për:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
  - b) ndryshimin e Statutit;
  - c) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit dhe caktimin e shpërblimit të tij/tyre;
  - d) emërimin dhe shkarkimin e likuidatori/eve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar dhe shpërblimin e tyre;
  - e) mbikyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
  - g) miratimin e zmadhimit dhe zvogëlimin të kapitalit të Shoqërisë;
  - h) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - i) perfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera në kundërshtim me administratorit/ëve;
  - j) shpërndarjen e fitimeve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
  - m) çështje tjetër të caktuar nga ligji ose nga ky Statut.
- n) Kërkesa për kredi bankare dhe / ose nënshkrimin të faturave, garanci ose garanci në favor të palëve të treta

### **NENI 15**

## **FINANCIMI I SHOQËRISË**



15.1 Organi i Administrimit te Shoqërisë në përputhje me dispozitat në fuqi përvec rasteve të zmadhimit te kapitalit ka të drejte të kërkoje nga ortakët e Shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë

15.2 Financimet e mëtejshme të ortakeve në shoqeri do të jene me shperblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të levrohen këto fonde.

## KREU IV ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

### NENI 16 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

16.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator ;

- Z. Rigels Shatraj, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë, me datë 02.03.1989 dhe banues në Tiranë, identifikuar me pasaportë nr.BR5393774 dhe numër personal I90302059F.


i cili emërohet nga ortakët e shoqërisë për një periudhë 5 vjecare me të drejtë rizgjedhje.

Administratori shkarkohet nga detyra, ne çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit te Shoqërisë.

Administratori ka kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:

- a) mbikeqyr dhe zbaton politiken e biznesit të Shoqërisë;
- b) përfaqëson Shoqërinë;
- c) kujdeset që Shoqëria të zbatojë ligjet dhe standartet e mbajtjes së llogarive;
- d) përgatit dhe nënshkruan bilancin dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shperndarjen e fitimeve ja paraqet Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- e) siguron që deklaratat e llogarive vjetore si dhe raporti i ecurisë së biznesit dhe çdo deklarim tjetër i detyrueshëm sipas ligjit ose statutit, janë bërë siç duhet;
- f) siguron që auditimi i librave dhe i të dhënave kryhet të paktën një herë në vit nga ekspertë kontabël të çertifikuar dhe raporti i llogaritaveve publike të çertifikuar t'i vihet në dispozicion Asamblesë së Përgjithshme;
- g) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencen e Shoqërisë;

16.2 Administratori mund të ndërmarrë apo të kërkoj kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë pervec atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakeve apo organeve të tjera të Shoqërisë.



**NENI 17**  
**SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT**

17.1 Shpërblimi i administratorit të shoqërisë do të përcaktohet nga Ortaku i shoqërisë.

**KREU V**  
**KONTROLI KONTABËL I SHOQËRISË**  
**VITI FINANCIAR DHE BILANCI**

**NENI 18**  
**KONTROLI KONTABËL**

18.1 Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspert Kontabel të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Ortakët do të emerojnë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në baze të ligjit.

**NENI 19**  
**VITI FINANCIAR**

19.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të cdo viti.

**NENI 20**  
**BILANCI DHE REZERVAT**

20.1 Me mbylljen e secilit vit financiar Administratorët marrin masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur në mënyrë që ortaket të vendosin mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.

20.2 Ortaket vendosin mbi ndarjen e dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma janë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.

20.3 Ortaket në cdo moment mund të vendosin krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre

**KREU VI**  
**PRISHJA DHE NJOFTIMET**

**NENI 21**  
**PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

21.1 Në rastin e likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"





## **NENI 22 NJOFTIMET**

22.1 Të gjitha njoftimet kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nese ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruarat prej tyre prane Administratoreve të Shoqërisë.

22.2 Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruarat prej tyre.

22.3 Në rastin kur një kuote zotërohet nga më shumë se një person të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

## **KREU VII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

### **NENI 23 LIGJI I ZBATUESHËM**

23.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt themelimi dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë Akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

23.2 Ky Akt hartohet në 4 (kater) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, dhe pasi lexohet nga Ortaku themelues, firmoset si më poshtë prej tij.

Ortaku i Vetem Themelues:

LULZIM KAPLLANAJ

**Lulzim Kapllanaj**

